



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të grupit të operatorëve ekonomik “Lindi Markings” Sh.P.K. & “Beni Com” Sh.P.K. të datës 24.03.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 20.03.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal Lot 4” me nr. të prokurimit 616-22-11147-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 170 211, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **MIRATOHET** kërkesa për rishqyrtim e grupit të operatorëve ekonomik “Lindi Markings” Sh.P.K. & “Beni Com” Sh.P.K. e datës 24.03.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues - Komuna e Prishtinës të datës 20.03.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal Lot 4” me nr. të prokurimit 616-22-11147-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 170 211 ashtu që **ANULOHE**T njoftimi mbi vendimin i datës 20.03.2023 i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në rivlerësim aktivitetin e prokurimit me titull “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal Lot 4” me nr. të prokurimit 616-22-11147-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 170 211.
- III. **NJOFTOHET** grupi i operatorëve ekonomik “Lindi Markings” Sh.P.K. & “Beni Com” Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Grupi i operatorëve ekonomik “Lindi Markings” Sh.P.K. & “Beni Com” Sh.P.K. (tutje “parashtruesi”) me datë 24.03.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues - Komuna e Prishtinës të datës 20.03.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Sinjalizimi horizontal dhe vertikal Lot 4” me nr. të prokurimit 616-22-11147-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 170 211.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim.

- 1. Pretendimi i parë:** *“Përgjatë periudhës kohore të vlerësimit të ofertave komisioni i vlerësimit nuk ka realizuar vizitë në terren...”, “Anëtarët e komisionit e realizojnë vizitën vetëm te kompania Lindi Marking Sh.P.K...”.*
- 2. Pretendimi i dytë:** *“Operatori ekonomik të cilin ju si AK e keni rekomanduar për dhënie të kontratës në ofertë ka prezantuar certifikatën EN 12899, standard i cili nuk është aplikuar në dosje të tenderit dhe njoftim për kontratë. Kërkesa e përcaktuar është certifikata UNE-EN1436”.*
- 3. Pretendimi i tretë:** *“materiali i kërkuar është material DG ndërsa operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie ka prezantuar mostrën nga materiali EGP...”.*
- 4. Pretendimi i katërt:** *“OE i rekomanduar për dhënie të kontratës A-testet i ka prezantuar në ofertë dhe atë në gjuhë Italiane, gjuhë kjo jozyrtare në RKS...”.*
- 5. Pretendimi i pestë:** *“nuk ka dëshmi lidhur me makinën për vijëzimin e masës plastike me papuqe të dimensioneve nga 12 cm -15 cm -20cm...”.*
- 6. Pretendimi i gjashtë:** *“Operatori ekonomik në ofertë ka bashkangjitur edhe kontratë për marrje me qira të njetit të punës Gjysme Rimorkio elektrike për sigurimin e vend punishtes të kontraktuar me El-Bau Sh.P.K., kontratë e cila përmban datën 24.10.2022 ku objekti i kontratës ka të bëjë me aktivitet tjetër të prokurimit...”.*
- 7. Pretendimi i shtatë:** *“Operatori ekonomik i ri rekomanduar për dhënie të kontratës në ofertë ka prezantuar shkresë të prodhuesit Vieser e cila dyshoj që është reale...”.*

Për shkak të pretendimeve si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues – Komuna e Prishtinës në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 13, 28, 59, 60, dhe 69 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje “LPP”).

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesit, janë administruar këto prova materiale si në vijim:

- njoftimi për kontratë i datës 12.10.2022;
- formulari B54 për korrigjimin e njoftimit për kontratë i datës 25.10.2022;
- formulari B54 për korrigjimin e njoftimit për kontratë i datës 03.11.2022;
- formulari B54 për korrigjimin e njoftimit për kontratë i datës 14.11.2022;
- formulari B54 për korrigjimin e njoftimit për kontratë i datës 22.11.2022;
- procesverbali i hapjes i datës 05.12.2022;
- oferta e operatorit ekonomik “Sinjal” Sh.P.K së bashku me mostrat e dorëzuara;
- raporti i komisionit për rivlerësim i datës 17.03.2023;
- njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontratës i datës 20.03.2023.

Pas njoftimit të datës 27.03.2023 për zgjatje të afatit për shqyrtimin e kërkesës për rishqyrtim në përputhje me nenin 61 paragrafin 61.3. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (tutje "RRPP"), autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 03.04.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim. Pas analizimit të pretendimeve të parashtruesit është gjetur se pretendimet numër një (1), dy (2), tre (3), pesë (5) dhe shtatë (7) janë pretendime të pabazuara në kuptim të nenit 62 paragrafit 62.1. nën paragrafi d) të RRPP. Njëkohësisht është gjetur se pretendimet numër katër (4) dhe numër gjashtë (6) të parashtruesit janë pretendime të bazuara në kuptim të nenit 63 paragrafit 63.1. nën paragrafi 63.1.2. të RRPP.

### **Pretendimet e pabazuara**

**Lidhur me pretendimin e parë:** parashtruesi fillimisht pretendon se komisioni për rivlerësim nuk ka dalur fare në terren për verifikim. Pastaj në kuadër të njëjtit pretendim konstaton se komisioni ka dalur në terren për verifikim mirëpo verifikimi nuk është bërë si duhet. Si i tillë ky pretendim i parashtruesit është kundërthënësi pasi që parashtruesi vet e demanton pretendimin e tij që komisioni nuk ka dalur fare në terren. Pavarësisht këtij fakti, për shqyrtimin e këtij pretendimi është administruar edhe raporti i komisionit për rivlerësim ku në faqen 14 dhe 19 konstatohet se komisioni ka dalur në terren për verifikim dhe njëkohësisht prezantohen të gjeturat e komisionit nga verifikimi në terren. Prandaj ndërmjet konstatimeve kundërthënëse të parashtruesit lidhur me pretendimin e parë si dhe raportit të komisionit si provë materiale të administruar në këtë rast, zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë provës materiale. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi i parë i parashtruesit është i pabazuar.

**Lidhur me pretendimin e dytë:** nga dosja e ofertës së tenderuesit të rekomanduar (si provë materiale e administruar në këtë rast) mund të vërtetohet se nga tenderuesi i rekomanduar është dorëzuar edhe çertifikata UNE-EN1436 siç është kërkuar në DT. Për këtë arsye pretendimi i dytë i parashtruesit është i pabazuar.

**Lidhur me pretendimin e tretë:** nga dosja e ofertës së tenderuesit të rekomanduar si dhe mostrat e dorëzuara (si provë materiale e administruar në këtë rast) mund të vërtetohet se materiali është dorëzuar si DG siç është kërkuar në DT dhe nuk është dorëzuar si EGP siç pretendon parashtruesi. Për këtë arsye pretendimi i tretë është i pabazuar.

**Lidhur me pretendimin e pestë:** nga raporti i komisionit të vlerësimit (si provë materiale e administruar) rezulton se pas daljes së komisionit në terren është verifikuar se tenderuesi i rekomanduar e ka në posedimin e pajisjes që e konteston parashtruesi, siç kërkohet me DT. Për këtë arsye pretendimi i pestë është i pabazuar.

**Lidhur me pretendimin e shtatë:** duhet theksuar se parashtruesi vetëm ka shprehur një dyshim se një shkresë nga kompania Vieser që ka dorëzuar tenderuesi i rekomanduar është shkresë reale! Megjithatë parashtruesi nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi dhe nuk ka paraqitur asnjë argument për të mbështetur pretendimin e tij. Njëkohësisht nuk ka arritur as të sqaroj përse kjo shkresë qenka jo-reale sipas parashtruesit. Për këtë arsye pretendimi i shtatë është i pabazuar.

## Pretendimet e bazuara

**Lidhur me pretendimin e katërt:** fillimisht duhet theksuar se përmes nenit 13 paragrafit 4 të LPP përcaktohet se *“Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze”*. Nga dosja e ofertës së tenderuesit të rekomanduar mund të vërtetohet se A-testet e materialeve të shenjave vertikale (kapacitetet teknike dhe profesionale) janë dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar janë në gjuhën italiane. Kjo është në kundërshtim me dispozitën ligjore të LPP të cituar si më sipër.

Përndryshe edhe në njoftimin për kontratë në seksionin e evidentuar si *“V.2) Informacionet shtesë”* është përcaktuar se *operatorët ekonomik do të kenë të drejtë të dorëzojnë tenderin, kërkesën për pjesëmarrje dhe dokumentet e tjera të nevojshme apo dosjet të cilat u lejohen gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze”*. Rrjedhimisht pretendimi i katërt i parashtruesit është i pretendim bazuar.

**Lidhur me pretendimin e gjashtë:** fillimisht duhet cekur se bazuar në nenin 23 paragrafin 23.3. të RRPP përcaktohet se *“Dëshmitë e përshtatshmërie dhe kualifikimit të tenderuesve përcaktohen në bazë të dosjes së tenderit. Dëshmitë mund të lidhen me: a. Kërkesat e përshtatshmërisë b. Përshtatshmëria profesionale c. Gjendja ekonomike dhe financiare d. Aftësitë teknike dhe / ose profesionale”*.

Nga dosja e ofertës mund të vërtetohet se *“Kontrata e qirasë për mjetin e punës”* e datës 24.10.2022 ndërmjet tenderuesit të rekomanduar *“Sinjal” Sh.P.K.* si qiramarrës dhe *“EL-BAU” Sh.P.K.* si qiradhënës, në nenin I të saj ka të përcaktuar se kjo kontratë lidhet për ekzekutimin e punimeve në projektin me titull *“Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve dhe vendbanimeve rurale”* me nr. të prokurimit 616-22-11453-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 175 211. Kjo është në kundërshtim me dispozitën e RRPP të cituar më sipër pasi që ky dokument i dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar nuk është **në bazë të dosjes së tenderit** për të cilin ka ofertuar përkatësisht për aktivitetin e prokurimit me titull *“Sinjalizimi horizontal dhe vertikal Lot 4”* me nr. të prokurimit 616-22-11147-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 170 211. Prandaj edhe pretendimi i gjashtë i parashtruesit është pretendim i bazuar.

Në këtë mënyrë është gjetur se lidhur me pretendimin e katërt dhe pretendimin e shtatë, parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Rrjedhimisht nga provat materiale të administruara lidhur me këtë kërkesë për rishqyrtim është gjetur se pretendimi i katërt dhe pretendimi i gjashtë i parashtruesit janë pretendime të bazuara. Kjo pasi që sipas pretendimit të katërt është gjetur se komisioni vlerësues ka vepruar në kundërshtim me nenin 13 paragrafin 4 të LPP. Ndërsa sipas pretendimit të gjashtë është gjetur se komisioni i vlerësimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 23 paragrafin 23.3. të RRPP. Për këto arsye është miratuar si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit.


Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 03.04.2023**

**Visar SHEHU**  
Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës



**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.